

Pse kontrollohet urina në shtatzani

Nga kontrolli i urinës mund të nxirren të dhëna jetike për shëndetin tuaj dhe të fëmijës.

Urina do të kontrollohet rregullisht gjatë shtatzanisë për:

- **Proteina** - shenjë e pre-eklampsisë
- **Glukozë** (sheqer) - shenjë e mundshme e diabetit, që mund të shfaqet për herë të parë gjatë shtatzanisë
- **Bakterje** - shenjë infeksioni

Ky informacion lidhet kryesisht me kontrollimin e urinës për pre-eklampsi (më parë të quajtur toksemi). Shenjat dhe simptomat e pre-eklampsisë shfaqen gjatë gjysmës së dytë të shtatzanisë. Tensioni i lartë arterial është një tjetër shenjë.

Gratë me pre-eklampsi zakonisht ndihen shumë mirë. Pikërisht për këtë arsye ka rëndësi të kryhen kontrole të rregullta të urinës dhe të tensionit arterial.

Si bëhet testi

Mamia ose mjeku zhytin një shirit letre një mostër urine të asaj dite. Testi do të tregojë nëse ka proteina në urinë si dhe sasinë e proteinave.

Kur sasia është shumë e vogël, kjo do të shenjohej në kartelën tuaj si 'trace' (gjurmë). Në këtë rast nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Nëse sasia është më e madhe, kjo do të shenjohej si një ose më shumë pluse (+), deri në 4 maksimum.

Po sikur të gjenden proteina?

Në rast se keni një ose më shumë pluse (+) proteina dhe tension të lartë arterial (zakonisht më shumë se 90 mm/Hg diastolik - numri më i vogël), mund të keni pre-eklampsi, në ç'rast do të keni nevojë për kujdes të posaçëm. Mund t'ju kërkohet të mblidhni urinën gjatë 24 orëve, për të parë sa proteinë keni saktësisht. Nuk ka shumë të ngjarë që proteinat në urinë të jenë shenjë infeksioni, sidomos në rast se nuk keni simptoma të tjera.

Si të mblidhni urinën në shtëpi

Mund t'ju kërkohet të mblidhni mostra urine në shtëpi dhe t'i sillni në klinikë për kontroll. Për këtë mund t'ju jepet një enë e posaçme ose mund t'ju thonë ta gjeni vetë një enë të përshtatshme. Çfarëdo ene që të përdorni, kujdesuni që të jetë e pastër dhe e shplarë mirë.

Ka tri lloje mostrash që mund t'ju kërkohen të mblidhni.

Ja si duhet të veproni:

1. **Urina e parë e mëngjesit**
Ditën e vizitës, mblidhni një sasi urine sapo të zgjoheni në mëngjes.
2. **Mostër 24-orëshe**
Mblidhni gjithë urinën që bëni gjatë një periudhe 24-orëshe:

Etapa 1 Pasi të zgjoheni, urinoni pa mbledhur urinë. Mamia ose mjeku mund t'ju kërkohen ta bëni këtë në një orë të caktuar të mëngjesit.

Etapa 2 Mblidhni gjithë urinën që bëni gjatë pjesës tjetër të ditës dhe natës. Zbrazeni sasinë e mbledhur në enën më të madhe, që do t'ju kenë dhënë në klinikë.

Etapa 3 Saktësisht 24 orë pas Etapës 1, mblidhni mostrën e fundit dhe hidhjeni në enën e madhe.

3. Mostër në mes të urinimit (MSU)
Shplajeni zonën gjenitale me ujë.

Pastaj kryeni veprimet e mëposhtme:

Filloni - urinoni një sasi të vogël urine në nevojto

Ndërpritni - kur ju ka mbetur ende shumë për të bërë

Merrni një mostër - vazhdoni të urinoni duke marrë mostrën

Pastaj përfundoni së urinuari në nevojto.

Në qoftë se harroni ta sillni mostrën në klinikë, kërkoni t'ju japin një enë dhe mblidhjeni urinën kur jeni ende atje.

Për t'u këshilluar ose informuar në lidhje me çdo aspekt të pre-eclampsisë, merrni në telefon linjën telefonike të ndihmës "Action on Pre-eclampsia" në numrin 0208 427 4217

Action on Pre-eclampsia
84-88 Pinner Road
Harrow
Middlesex
HA1 4HZ

Email: info@apec.org.uk
www.apec.org.uk

Bamirësi e regjistruar No: 1013557
Kompani e regjistruar No: 2736320